

Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese

# MONITORIMI I SISTEMIT ARSIMOR

Raport i monitorimit të shkollave fillore dhe i atyre të mesme në: Prishtinë, Mitrovicë, Ferizaj, Pejë, dhe Gjiilan

Qershor 2009,  
Prishtinë





Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese  
Balkan Investigative Reporting Network

# MONITORIMI I SISTEMIT ARSIMOR

Raport i monitorimit të shkollave fillore dhe i atyre të mesme në: Prishtinë, Mitrovicë, Ferizaj, Pejë, dhe Gjiilan

Autore: Fatmire Tërdevci

Monitoruesit: Betim Musliu, Isa Gacaferi, Jusuf Thaçi, Faton Ademi,  
Valdrin Beka, Fatmire Haliti, Jehona Ahmeti dhe  
Edona Musa

Redaktore: Jeta Xharra

# FALËNDERIMET

BIRN-i falënderon në mënyrë të posaçme organizatat: “Rockefeller Brothers Fund”, “Charles Stewart Mott Foundation”, “Balkan Trust for Democracy” dhe Komisionin Evropian, organizata këto të cilat kanë mundësuar projektin e monitorimit me mbështetjen e tyre financiare.

BIRN-i falënderon në mënyrë të posaçme: Halim Hysenin, udhëheqës i Divizionit për zhvillimin e programeve trajnuese në Qendrën e Arsimit të Kosovës (KEC), Dëfrim Gashin, drejtor i Departamentit të Inspektoratit në MASHT, Nehat Mustafën, këshilltar në MASHT, Jonuz Salihajn, ekspert i arsimit, Ismet Poterën, drejtor i Institutit Pedagogjik të Kosovës, Hajdar Binakun, drejtor i SHM “28 Nëntori” në Prishtinë, Xheraldina Rexhepin, kryetare e Këshillit të Prindërve në SHF “Hasan Prishtina” në Prishtinë, Ismet Kurteshin, drejtor komunal i Arsimit (DKA) në Gjilan, Florin Metajn, drejtor i DKA-së në Prizren, Sylejman Bytyçin, drejtor i DKA-së në Ferizaj, Ilir Kelmendin, drejtor i DKA-së në Pejë, Riza Hazerin, drejtor i DKA-së në Mitrovicë, Shyqri Obërtincën, drejtor i SHF “Hasan Prishtina” në Prishtinë, Valbona Kastratin, drejtoreshë e SHF “Meto Bajraktari” në Prishtinë, Syzana Hysenin, drejtoreshë e SHF “Elena Gjika” në Mitrovicë, Hamdi Shytin, drejtor i shkollës “Migjeni në Mitrovicë, Faik Berishën, drejtor i shkollës fillore “Afrimi dhe Fahriu” në fshatin Lluzhan të Podujevës, Imri Musliun, zëvendësdrejtor i SHMT-së në Ferizaj, Nexhmi Lecin, drejtor i SHM “Abdyl Frashëri” në Prishtinë, Rabbit Ademin, drejtor i SHF “Thimi Mitko” në Gjilan, Veton

Breznicën, kryetar i Këshillit të Nxënësve në SHM “28 Nëntori” në Prishtinë, Isa Morinën, Valon Bytyçin dhe Samir Zullanin, përfaqësues të Këshillit të Nxënësve në Prishtinë, Nazrie Aliarifin, drejtoreshë e SHF “Emin Duraku” në Prizren, Ridvan Hoxhën, drejtor i Shkollës së Mesme të Mjekësisë në Prizren, të cilët me informatat e tyre e kanë ndihmuar përgatitjen dhe realizimin e këtij raporti.

Gjithashtu, BIRN-i falënderon të gjithë drejtorët e shkollave të monitoruara për lejin e qasjes dhe marrjes së informacioneve nga monitoruesit, si dhe të gjithë nxënësit, të cilët kanë ofruar informacione në mënyrë anonime.

Projekti i monitorimit është bërë i mundur edhe në sajë të bashkëpunimit me organizatat joqeveritare lokale: “Syri i Vizionit” në Pejë, “Community Building Mitrovica” në Mitrovicë dhe “INPO” në Ferizaj. Këto organizata, jo vetëm që kanë ndihmuar monitoruesit e BIRN-it me ofrimin e hapësirës për të punuar, por gjithashtu kanë bashkëpunuar me ta përkritazi me ofrimin e informacioneve.

*“Ky publikim është prodhuar me ndihmën e Komisionit European. Përmbajtja e këtij publikimi është vetëm përgjegjësi e BIRN-it dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si pasqyrim i pikëpamjeve të Komisionit European.”*

# PËRMBAJTJA

|   |    |
|---|----|
| PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE                                  | 8  |
| METODOLOGJIA  | 12 |
| PRAPAVIJA   | 13 |
| GJETJET E MONITORIMIT NËPËR SHKOLLA                     | 15 |
| 1. Niveli i ulët i njohurive të nxënësve                | 16 |
| 2. Mungesa e teksteve shkollore dhe e punës praktike    | 18 |
| 3. Tekstet shkollore joadekuate                         | 20 |
| 4. Klasat e mbingarkuara me nxënës                      | 21 |
| 5. Dhuna në shkolla                                     | 23 |
| 6. Përdorimi i drogës në shkollë                        | 25 |
| 7. Mësimdhënësit mbajnë kurse private                   | 26 |
| 8. Mosmbajtja e orëve të mësimit                        | 27 |
| 9. Papastërtia në institucionet shkollore               | 28 |
| 10. Testi i maturës                                     | 29 |
| 11. Parregullsitë në punësimin e stafit të shkollave    | 33 |
| REKOMANDIME   | 36 |
| Tabelat me të dhënat e pyetësorëve për sistemin arsimor | 39 |
| Lista e shkurtesave                                     | 50 |

# PËRMbledhje Ekzekutive

Gati dhjetë vjet pas përfundimit të luftës, sistemi i arsimit mbetet një ndër sfidat më të mëdha në Kosovë. Me gjithë investimet e bëra që nga qershori i vitit 1999 në ngritjen e kapaciteteve të institucioneve arsimore dhe implementimin e reformave në këtë sistem, kualiteti i arsimit vazhdon të mbetet në një nivel të ulët, i karakterizuar nga një varg problemesh si: mungesa e teksteve shkollore adekuate, mungesa e hapësirave shkollore, dhuna nëpër shkolla, mungesa e një monitorimi të vazhdueshëm, mungesa e një inspektimi të kualitetit të mësimdhënies, përdorimi i drogës nga një numër i madh nxënësish, etj.

Të gjitha këto probleme kanë ndikuar drejtpërsëdrejti në nivelin e ulët të njohurive të nxënësve në nivelin fillor dhe në atë të mesëm. Një numër i nxënësve, megjithëse në përfundim të shkollës së mesme, kanë treguar se nuk janë në gjendje të shkruajnë dhe të lexojnë rrjedhshëm, derisa një numër i tyre nuk i kanë përvetësuar njohuritë më themelore gjatë arsimit të tyre, gjë që nxjerr në pah problemin e vlerësimit joobjektiv të brendshëm të bërë nga shkollat. Shumë nxënës vlerësohen me nota maksimale nga mësimdhënësit e tyre, ndërkaq vlerësimi i jashtëm që bëhet nëpërmjet testit të maturës nuk e vërteton një sukses të tillë. Nxënësit përcillen në klasë më të lartë me gjithë nivelin shumë të ulët të njohurive që shkon deri në paaftësinë për të shkruar dhe lexuar dhe kjo bën që mësimdhënësit në vend të planprogramit adekuat, të zhvillojnë me nxënës mësimin e shkronjave. Ky problem është shumë i theksuar sidomos në shkollat profesionale, ku mësimet i vijojnë nxënësit me sukses më të dobët.

Të dhënat e MASHT-it për suksesin e nxënësve të treguar gjatë gjysmëvjetorit të parë të vitit shkollor 2008/09 flasin për gjendjen alarmante lidhur me rezultatet shumë të dobëta të nxënësve në arsimin e ulët të mesëm (klasat 6-9) dhe në arsimin e mesëm të lartë (klasat 10-13). Këto statistika tregojnë se 28% e nxënësve, të cilët e vijojnë mësimin në nivelin e arsimit të mesëm të ulët, kanë treguar sukses të dobët në gjysmëvjetorin e parë të këtij viti shkollor, një përç-

indje e cila ngrihet në mënyrë rapide në nivelin e mesëm të lartë, ku 60.2% e nxënësve të klasës së dhjetë kanë kaluar këtë gjysmëvjetor me nota të dobëta, 59.6% në klasën e njëmbëdhjetë, 59.3% në klasën e dymbëdhjetë dhe 60.4% në klasën e trembëdhjetë.

Reformat e bëra janë treguar të pasuksesshme dhe aspak produktive në ngritjen e nivelit të arsimit dhe këto reforma janë bërë në mënyrë të centralizuar dhe pa pjesëmarrjen e ekspertëve të arsimit. Megjithëse ishte paraparë të themelohej këshilli i ekspertëve për plane dhe programe, një gjë e tillë nuk ka ndodhur. Në këtë mënyrë, të gjitha planet dhe programet nënshkruhen dhe aprovohen nga vetë ministri.

Derisa nxënësit e shkollave fillore janë të stërngarkuar me tekste shkollore, nxënësve të shkollave të mesme, sidomos të shkollave profesionale u mungojnë ato, ashtu siç u mungon edhe puna praktike, e cila është e domosdoshme për ta. Nxënës të drejtmeve si: ekonomi, arkitekturë, bujqësi, inxhinieri etj., përveçse nuk kanë tekste adekuate për drejtimin e tyre, ata nuk kanë mundësi të bëjnë punë praktike për shkak të mungesës së vendeve ku ata mund ta zhvillojnë atë. Në mungesë të teksteve shkollore, mësimdhënësit e zhvillojnë lëndën mësimore duke u diktuar nxënësve, një metodë e cila nuk lë hapësirë për interaksion dhe diskutim gjatë orës mësimore.

Një nga dukuritë e vërejtura gjatë monitorimit është mbajtja e kurseve private nga ana e një numri të mësimdhënësve nëpër shkollat e mesme dhe ato fillore, gjë që, sipas nxënësve të tjerë, të cilët nuk kanë mundësi financiare që t'i vijojnë këto kurse, ndikon në vlerësimin me nota maksimale të nxënësve, të cilët i vijojnë ato, edhe nëse ata nuk tregojnë rezultat maksimal në përvetësimin e lëndës në fjalë.

Një ndër faktorët, të cilët ndikojnë po ashtu në nivelin e ulët të njohurive të nxënësve nëpër shkolla, është edhe mungesa e hapësirës shkollore. Për këtë arsye, shumica e shkollave punojnë në dy, tri madje edhe në katër ndërresa, ndërsa një numër fare i vogël punon në një ndërresë. Si pasojë e kësaj, ora e mësimit

në shumë shkolla që punojnë me ndërresa zgjat 40, 35, 30, madje edhe 25 minuta dhe jo 45 që është koha standarde e një ore mësimore. Mungesa e objekteve të mjaftueshme shkollore çon te një faktor tjetër, i cili, po ashtu, ka ndikim të drejtpërdrejtë në cilësinë e arsimit në Kosovë dhe që ka të bëjë me mbingarkimin e klasave me nxënës. Në shumë raste, ky numër shkon deri në 45, 47 madje edhe në mbi 50 nxënës, çfarë pamundëson angazhimin e mësimeve në përmbushjen e planprogramit dhe në plotësimin e nevojave të nxënësve në përvetësimin e këtyre planprogrameve.

Humbja e orëve të mësimin për shkak të reduktimeve të energjisë elektrike është një problem tjetër me të cilin ballafaqohen shkollat. Për shkak të këtyre reduktimeve, shumë nxënës të ndërrësës së pasdites nuk i mbajnë orët e mësimin, sepse nuk punon gjeneratori i shkollës. Shkollave në Kosovë u mungojnë edhe laboratorët dhe kabinetet, duke bërë që nxënësit të mësojnë vetëm teori, duke mos pasur mundësi që këtë teori ta kombinojnë edhe me punë praktike në një lëndë të caktuar. Derisa shkollat në qendra të mëdha janë të pajisura në një masë të vogël me kabinate dhe laboratorë, që janë të pamjaftueshëm për numrin tepër të madh të nxënësve që i vijojnë këto shkolla, shkollave nëpër fshatra u mungojnë tërësisht këto pajisje.

Monitorimi i BORN-it ka nxjerrë në pah edhe një shkallë tepër të madhe të dhunës nëpër institucionet shkollore. Kjo dhunë ndahet në tri lloje: dhuna e nxënësve ndërmjet vete, dhuna e mësimeve ndaj nxënësve dhe dhuna e jashtme, e cila vjen nga personat jashtë shkollës e drejtuar ndaj nxënësve. Një gjë e tillë është konfirmuar nga shumë nxënës, të cilët kanë treguar për një shkallë të lartë të dhunës që ushtrohet ndërmjet nxënësve dhe nga ana e mësimeve mbi nxënësit. Nga një dhunë e tillë, disa nxënës kanë kërkuar edhe ndihmë mjekësore.

Në anën tjetër, një numër nxënësish madje bartin me vete në shkollë edhe thika dhe mjete të tjera, të cilat i përdorin gjatë përlëshjeve me nxënësit e tjerë ose me personat jashtë shkollës. BORN-i madje ka qenë edhe dëshmitar i situatave dhe i skenave të tilla të përlëshjeve në oborret e shkollave.

Në shumë shkolla nuk ka roja që do të kujdeseshin edhe për sigurinë e nxënësve. Në disa raste rojë bëjnë vetë nxënësit e shkollave apo stafi teknik i shkollës. Të dy këto raste, ata nuk mund të bëjnë sigurim efikas të objektit shkollor dhe të nxënësve. Mungesa e personave përgjegjës në hyrje të institucioneve shkollore ka si pasojë mosndalimin e dhunës. Gjatë monitorimit, BIRN-i ka marrë informacione edhe për rritjen e ndjeshme të përdorimit të drogës nëpër shkolla të mesme, madje në disa raste edhe në shkollat fillore. Nxënësit e intervistuar kanë pohuar se droga shitet dhe ofrohet nga vetë disa nxënës, të cilët shërbejnë si agjentë të shitjes nga persona të tjerë jashtë shkollës. Përveç drogave të lehta si marihuanë dhe hashash, në disa shkolla përdoren edhe droga të rënda si kokaina dhe heroina.

Me gjithë shkallën e lartë të dhunës dhe të përdorimit të drogës, janë dy dukuri gjithnjë në rritje, në 23% të shkollave nuk ofrohet përkrahje psiko-sociale, ndërsa në 31.9% të shkollave një gjë e tillë ofrohet nga stafi i shkollës, i cili nuk është i specializuar për një gjë të tillë. Duke pasur parasysh se në Kosovë mungojnë edhe qendrat, të cilat merren me trajtim psiko-social të nxënësve me sjellje josociale dhe agresive, problemi i mungesës së psikologëve nëpër shkolla bëhet edhe më i madh.

Gjatë monitorimit, BIRN-i ka vërejtur edhe një nivel shumë të ulët të pastërtisë nëpër institucionet shkollore. Me gjithë numrin tepër të madh të nxënësve, punën në disa ndërresa dhe reduktimet e vazhdueshme të ujit, shkollat nuk kanë rezervuarë uji, duke bërë që nxënësit t'i ekspozohen rrezikut të epidemive të ndryshme, siç ka ndodhur në fshatin Studençan të Suharekës, i prekur nga epidemia e verdhëzës. Inspektorati Sanitar i Ministrisë së Shëndetësisë kishte urdhëruar mbylljen për disa ditë të shkollës së fshatit për shkak të përhapjes së kësaj epidemie. Lidhur me nivelin e ulët të pastërtisë në objektet shkollore, sidomos në tualete, një rol të madh luan angazhimi i udhëheqjes së shkollave. Derisa një shkollë, me gjithë mungesën e ujit dhe mjeteve higjienike, ka nivel më të lartë të pastërtisë, ndërkaj në një shkollë të tjetër, ky nivel është shumë i ulët, pikërisht për shkak të mosangazhimit të udhëheqjes së shkollës.

Gjatë monitorimit, BIRN-i ka evidentuar edhe një problem tjetër në sistemin arsimor që ka të bëjë me parregullsitë në punësimin e stafit të shkollave. Në disa raste që janë hulumtuar nga BIRN-i, janë punësuar drejtorë ose sekretarë shkollash, me gjithë faktin se kandidatët e tjerë i kishin plotësuar më mirë kriteret e kërkuara. Megjithëse, një gjë e tillë nuk ka mundur të vërtetohet qartë, kandidatët të cilët nuk janë zgjedhur në postet për të cilat kanë konkurruar, kanë shprehur dyshimet e tyre se moszgjidhja e tyre është e motivuar politikisht.

## METODOLOGJIA

Gjatë periudhës mars 2008 - mars 2009, BIRN-i ka bërë monitorimin sistematik të shkollave fillore dhe të atyre të mesme në këto komuna: Prishtinë, Mitrovicë, Ferizaj, Pejë dhe Gjiilan. Monitoruesit gjithashtu kanë siguruar informacione edhe për funksionimin e shkollave në: Vushtrri, Obiliq, Fushë Kosovë, Shtime dhe Podujevë. Gjatë kësaj periudhe janë plotësuar 350 pyetësorë, për plotësimin e të cilëve janë intervistuar nxënës, mësime, drejtorë shkollash, por bazuar edhe në vëzhgimin nga ana e monitoruesve.

Një aspekt tjetër i monitorimit përfshin edhe të dhënat kualitative, për marrjen e të cilave janë përdorur edhe burime të tjera si ekspertë të nivelit arsimor filor dhe të mesëm, prindër, kryetarë këshillash të nxënësve dhe përfaqësues të organizatave joqeveritare rinore.

Gjatë punës njëvjeçare, janë bërë hulumtime specifike me qëllim të marrjes së informatave të hollësishme lidhur me suksesin e dobët dhe nivelin e ulët të njohurive të nxënësve dhe përdorimin e substancave narkotike nëpër shkolla. Këto hulumtime kanë shërbyer për përgatitjen e raporteve televizive dhe debateve për këto tema.

# PRAPAVIJA

## Të dhëna për sistemin arsimor në Kosovë

Pas disa vitesh të segregacionit nën regjimin serb, i cili pasoi pas heqjes së autonomisë së Kosovës në vitin 1989, arsimit në Kosovë pati pasoja të rënda. Në vitin 1991, të gjitha shkollat e mesme, Universiteti i Prishtinës dhe disa shkolla fillore u mbyllën për nxënësit dhe studentët shqiptarë, derisa të gjithë mësimdhënësit shqiptarë u përjashtuan nga puna. Pas dëbimit, stafi mësimdhënës shqiptar, nxënësit dhe studentët u detyruan t'i zhvillonin mësimet nëpër shtëpi private dhe nëpër bodrume. Kjo formë e arsimit u bë e njohur me emrin "sistemi paralel i arsimit". Nxënësit dhe studentët shqiptarë nuk kishin qasje në bibliotekat publike, në sallat sportive, në laboratorë, etj. Pagat e mësimdhënësve shqiptarë të angazhuar në këtë sistem paralel siguroheshin nga fondet e siguruara nga diaspora shqiptare në vendet perëndimore.

Në atë kohë, për shkak të përndjekjes dhe shtypjes nga autoritetet serbe, shumë familje shqiptare u detyruan të largohen nga Kosova, duke u bërë azilkërkues në vendet e Evropës Perëndimore. Midis tyre kishte shumë mësimdhënës, gjë që pati ndikim të menjëhershëm në rënien e kualitetit të mësimdhënies në Kosovë. Shumë të rinj po ashtu u larguan nga vendi, disa për shkak të kushteve ekonomike, ndërsa shumë të tjerë braktisën shkollën për shkak të rrezikut të përndjekjes nga policia serbe gjatë vijimit të mësimet, si dhe për shkak të mungesës së perspektivës së punësimit. Një braktisje e madhe e shkollës u shënua në këtë periudhë.

Sidoqoftë, sistemi paralel i arsimit pati më shumë efekt rezistues ndaj regjimit të atëhershëm serb se sa që pati rezultate në kuptimin e një arsimit të mirëfilltë të ofruar nga shtëpitë e shndërruara në shkolla. Gjenerata të tëra nxënësish që vijuan mësimet në këtë sistem, patën mangësi të mëdha në përvetësimin e njohurive të nevojshme. Disa prej tyre aktualisht janë mësimdhënës.

Sidoqoftë, sistemi i arsimit pati pasojat më të rënda gjatë luftës në Kosovë gjatë

viteve 1998-1999, kur shumica e shkollave u dogjën dhe u shkatërruan. Nga qershori i vitit 1999, sistemi i arsimit në Kosovë ka qenë në kompetencë të Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), përkatësisht të Departamentit të Arsimit dhe të Shkencës, i kryesuar nga një zyrtar ndërkombëtar dhe një vendor.

Me themelimin e Qeverisë së parë të Kosovës, në mars të vitit 2002 (pas zgjedhjeve të para të përgjithshme të mbajtura në nëntor të vitit 2001), kompetencat mbi arsimin i mori Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë e Kosovës (MASHT) bazuar në Kornizën Kushtetuese të Vetëqeverisjes në Kosovë. Edhe pse organizata të ndryshme joqeveritare ndërkombëtare dhe qeveri të vendeve perëndimore financuan rindërtimin e shkollave në Kosovë, shumë nxënës, sidomos ata në zonat rurale, mbanin mësimet e tyre në kontejnerë, tenda dhe në shkolla tejet të dëmtuara. Disa nga këto shkolla-kontejnerë ende përdoren për mësim. Derisa rindërtimi fizik i objekteve shkollore ishte i shpejtë, implementimi i reformave nuk ishte aspak i suksesshëm dhe u bë pa përgatitje paraprake.

Sipas të dhënave të MASHT-it, aktualisht në shkollat fillore dhe në ato të mesme të Kosovës, mësimin e vijojnë 443.912 nxënës, prej tyre 5.091 në nivelin parashkollor, 19.679 në nivelin parafillor 19.679, në nivelin fillor të mesëm dhe të ulët 322.975 dhe të mesëm të lartë 96.172 nxënës. Ndërsa numri i personelit të angazhuar në shkollat fillore dhe në ato të mesme në Kosovë është 27.623, prej tyre 22.925 mësimdhënës, ndërsa të tjerët i takojnë personelit të administratës dhe atij ndihmës.

Që prej përfundimit të luftës në vitin 1999, në Kosovë funksionon edhe sistemi paralel i arsimit, të cilin e vijojnë nxënësit serbë, të cilët mësojnë me planprograme dhe tekste shkollore të Serbisë. Në vitin 2004, numri i tyre ka qenë 14,368.<sup>1</sup>

---

<sup>1</sup> Raporti i Iniciativës Evropiane për Stabilitet (ESI) "Parimi i Lozanës: Multietniciteti, territori dhe e ardhmja e serbëve të Kosovës", qershor 2004

Sistemi i arsimit në Kosovë është i rregulluar me një varg ligjesh<sup>2</sup> dhe me 290 udhëzime administrative. Të gjitha ligjet dhe udhëzimet administrative mund të lexohen në faqen zyrtare të internetit të MASHT-it.<sup>3</sup>

# GJETJET E MONITORIMIT NËPËR SHKOLLA

Qëllimi i këtij monitorimi është që të identifikohen problemet me të cilat ballafaqohet arsimi kosovar. Dukuritë më të shpeshta të identifikuara janë: niveli i ulët dhe suksesi shumë i dobët i nxënësve në të dy nivelet, si në atë fillor ashtu edhe në atë të mesëm, shkalla e madhe e dhunës, vlerësimi joobjektiv i nxënësve nga ana e mësimitdhënësve, mbajtja e kurseve private nga ana e mësimitdhënësve, infrastruktura e keqe e objekteve shkollore, mungesa e pajisjeve shkollore, mungesa e materialit shkollor, hapësira e pamjaftueshme shkollore, klasat e mbingarkuara me nxënës dhe përdorimi i drogës nëpër shkolla.

Gjatë monitorimit janë plotësuar pyetësorët nga intervistat me nxënës, ndërsa për të dhënat kualitative janë përdorur edhe burime të tjera si ekspertë të nivelit arsimor fillor dhe të mesëm, prindër, kryetarë këshillash të nxënësve dhe përfaqësues të organizatave joqeveritare rinore.

---

2 Ligji mbi arsimin fillor dhe të mesëm në Kosovë, nr. 2002/2; Ligji për arsimin e lartë në Kosovë, nr. 2002/03; Ligji për inspeksionin e arsimit në Kosovë, nr. 2004/37; Ligji për arsimin dhe aftësimin e të rriturve, nr. 02/L-24; Ligji për arsimin dhe aftësimin profesional, nr. 02/L-42; Ligji mbi veprimtarinë kërkimore-shkencore, nr. 2004/42; Ligji mbi botimin e teksteve shkollore, mjeteve mësimore, lektyrës shkollore dhe të dokumentacionit pedagogjik, nr. 02/L-67; Ligji mbi arsimin në komunat e Republikës së Kosovës, nr. 03/L-068, 2008; Ligji për provimin përfundimtar dhe provimin e maturës shtetërore, nr. 03/L-018; Ligji për kualifikimet kombëtare, nr. 03/L-060

3 [www.masht-gov.net](http://www.masht-gov.net)

# 1. Niveli i ulët i njohurive të nxënësve

Sfida më e madhe për arsimin në Kosovë është niveli i ulët i njohurive të nxënësve të shkollave fillore dhe të aatyre të mesme në Kosovë. Gjatë hulumtimit të bërë në muajt maj dhe qershor të vitit 2008, janë intervistuar shumë mësime dhe nxënës nëpër komuna, të cilët kanë pohuar se është një numër i nxënësve të cilët nuk e kanë përvetësuar ende shkrim-leximin, ndonëse e vijojnë mësimin në ciklin e mesëm të ulët, madje edhe në shkollë të mesme.

Hulumtimi ka nxjerrë në pah të metat ligjore, të cilat kanë ndikuar drejtpërdrejt në përmasat e kësaj dukurie. Udhëzimi administrativ 50/04 ndalon përsëritjen e klasës nga e para në të gjashtë. Në pikën 10.10 të nenit 10, e cila ka të bëjë me vlerësimin e shkallës së arritshmërisë, thuhet: "Në arsimin fillor, klasa 1 deri 5 nxënës nuk mund të shpallet përsëritës por përcillet në klasën vijuese". Sipas mësime dhe nxënësve të shkollës së mesme në Pejë, Emine Tolaj, në çdo klasë ku ajo jep mësim, ekzistojnë dy, tre deri në pesë nxënës, të cilët nuk dinë shkrim-lexim. Ajo ka pohuar të mos jetë në gjendje t'i përmbahet planprogramit, duke qenë e detyruar të bëjë alfabetin dhe mësimin e shkronjave për nxënësit e klasave të 10-ta, 11-ta dhe 12-ta ku ajo jep mësim. BORN-i ka arritur ta vërtetojë një gjë të tillë edhe nëpërmjet filmimit të një nxënëseje të klasës së 12-të, e cila kishte probleme të theksuara në të lexuar.

Një fakt i tillë është konfirmuar dhe mbështetur edhe nga Ismet Potera, drejtor i Institutit Pedagogjik të Kosovës, i cili, përveç nivelit të ulët të njohurive të nxënësve, ka përmendur edhe nivelin e ulët të njohurive të vetë mësime dhe nxënësve, të cilët, për shkak të mungesës së inspektimit dhe sigurimit të kualitetit nga ana e Ministrisë së Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë (MASHT), lejohen të japin mësim.

Gjatë javës së tretë të muajt maj, BORN-i ka intervistuar nxënës të katër shkollave fillore: "Zenel Hajdini", "Elena Gjika", "Nazim Gafurri" dhe "Hasan Prishtina" në Prishtinë, ku nxënësit e intervistuar kanë pohuar që në këto shkolla ka nxënës në klasë të lartë që nuk dinë shkrim-lexim. Kështu kanë deklaruar edhe

nxënësit e shkollave të mesme: “Eqrem Cabej” dhe “28 Nëntori”, në Prishtinë, ndërsa nxënësit e intervistuar të shkollave të mesme “Ali Sokoli” dhe “Sami Frashëri” në Prishtinë kanë thënë se në këto shkolla nuk ka raste të tilla.

Zyrtarë të MASHT-it kanë pranuar të jenë në dijeni të problemit. I intervistuar nga BIRN-i në muajin shtator, këshilltari i ministrit të Arsimit, Nehat Mustafa, ka thënë se MASHT-i do ta rrisë numrin e inspektorëve të arsimit, të cilët do t'i inspektojnë mësimdhënësit gjatë orëve të mësimit.<sup>4</sup>

Megjithatë, numri i inspektorëve të arsimit nuk është rritur. Drejtori i Departamentit të Inspektoratit në MASHT, Dëfrim Gashi, i ka thënë BIRN-it se MASHT-i ka 55 inspektorë të arsimit, të cilët mbulojnë tërë territorin e Kosovës.<sup>5</sup> Gjatë monitorimit, monitoruesit nuk kanë vërejtur praninë e këtyre inspektorëve nëpër shkolla.

Të dhënat e MASHT-it për suksesin e nxënësve të treguar gjatë gjysmëvjetorit të parë të vitit shkollor 2008/09 flasin për gjendjen alarmante lidhur me rezultatet shumë të ulëta të nxënësve në arsimin e ulët të mesëm (klasat 6-9) dhe arsimin e mesëm të lartë (klasat 10-13). Këto statistika tregojnë se 28% e nxënësve të cilët vijojnë mësimin në nivelin e arsimit të mesëm të ulët kanë treguar sukses të dobët në gjysmëvjetorin e parë të këtij viti shkollor, një përqindje e cila ngrihet në mënyrë rapide në nivelin e mesëm të lartë, ku 60.2% e nxënësve të klasës së dhjetë kanë kaluar këtë gjysmëvjetor me nota të dobëta, 59.6% në klasën e njëmbëdhjetë, 59.3% në klasën e dymbëdhjetë dhe 60.4% në klasën e trembëdhjetë.

Sipas ekspertit për arsim parauniversitar, Halim Hyseni<sup>6</sup>, njohuritë e mangëta të nxënësve kanë të bëjnë me planprogramet joadekuate, të cilat, sipas tij, janë të vjetërsuara, shumë të ngarkuara dhe të gabuara. Një arsye tjetër për moszbatimin e reformave, sipas Hysenit, është mungesa e analizave paraprake, të detajuara, të cilat janë bërë në vendet e tjera si në Rumani, Slloveni etj., për të identifikuar pikat e dobëta dhe të forta të arsimit.

4 Intervistë me z. Nehat Mustafa, shtator 2008

5 Intervistë me z. Dëfrim Gashi, mars 2009

6 Intervistë me z. Halim Hysenin, mars 2009

Mosangazhimi i ekspertëve të arsimit për përpilimin e kurrikulave është një problem tjetër, sipas Hysenit, që ka ndikuar në moszbatimin e reformave. Megjithëse këshilli i ekspertëve ishte paraparë që të themelohej për plane dhe programe, një gjë e tillë nuk ka ndodhur. Në këtë mënyrë, të gjitha planet dhe programet nënshkruhen dhe aprovoen nga vetë ministri.

Vetëm disa ditë pas miratimit të Ligjit për arsim fillor dhe të mesëm në Kosovë në vitin 2002 është filluar me klasën e 9-të, megjithëse nuk ka pasur libra dhe planprograme për këtë klasë, duke ndikuar drejtpërsëdrejti në rënien e suksesit të nxënësve. "Shumë nxënës, të cilët deri në klasën e 8-të kanë qenë të shkëlqyeshëm, në klasën e nëntë pothuajse kanë dështuar. Në mungesë të teksteve dhe kurrikulave ka bërë që shumë njerëz të dështojnë", ka thënë Halim Hyseni, ekspert i arsimit.

Pyetjes se çfarë e pengon implementimin e metodave bashkëkohore në mësimdhënie, nga 513 njerëzit e intervistuar 23 prej tyre i janë përgjigjur se është mungesa e teksteve adekuate, për 68 prej tyre numri i madh i nxënësve nëpër klasa, 72 kanë thënë se është mungesa e mjeteve konkretizuese, 177 kanë përmendur mungesën e kabineteve, laboratorëve dhe sallave, ndërkaq 13 kanë përmendur paaftësinë/mosgatishmërinë e mësimdhënësve (shih tabelën 21).

## 2. Mungesa e teksteve shkollore dhe e punës praktike

Derisa nxënësit e shkollave fillore janë të stërngarkuar me tekste shkollore, nxënësve të shkollave të mesme, sidomos të shkollave të atyre profesionale u mungojnë ato, ashtu siç u mungon edhe puna praktike, e cila është e obligueshme për ta. Nxënës të drejtimeve si: ekonomi, juridik, arkitekturë, bujqësi, inxhinieri, etj., përveçse nuk kanë tekste adekuate për drejtimit e tyre, ata nuk kanë mundësi të bëjnë punë praktike për shkak të mungesës së vendeve ku ata mund ta zhvillojnë atë.

Drejtori i shkollës së mesme profesionale “28 Nëntori” në Prishtinë, Hajdar Binaku, dhe mësimdhënës të kësaj shkolle kanë thënë se, përveç mungesës së teksteve shkollore, shkolla ballafaqohet edhe me mungesën e punës praktike për nxënësit. Ai ka theksuar se shkolla ka bërë marrëveshje me disa kompani private, ku nxënësit bëjnë punën praktike. Derisa MASHT-i, sipas tij, nuk ka ndihmuar në gjetjen e vendeve për punë praktike për nxënësit e kësaj shkolle, Komuna e Prishtinës u ka mundësuar nxënësve të gjeodezisë për të punuar bashkë me gjeodezistët e saj në terren.

Sipas tij, për asnjë drejtim të kësaj shkolle nuk ka tekste mësimore.<sup>7</sup>

Ish-nxënësi i shkollës së mesme profesionale “Faik Konica” në Ferizaj, Ardit Gashi, ka thënë të mos ketë pasur asnjë tekst shkollor gjatë katër viteve të mësimit në shkollën e mesme. “Derisa unë nuk kam pasur asnjë libër të drejtimit juridik, motra ime në klasën e dytë të shkollës fillore ka tre libra të gjuhës shqipe dhe tre libra të matematikës”, ka thënë ai.<sup>8</sup>

Informata të njëjta ka pasur edhe nga shkollat e tjera profesionale nëpër komuna e tjera. Në një situatë më të mirë, përkritazi me punën praktike, janë nxënësit e shkollave të mesme të mjekësisë, të cilët punën praktike e zhvillojnë nëpër institucionet shëndetësore.<sup>9</sup> Punë praktike mbajnë pjesërisht edhe nxënësit e shkollës së mesme teknike “Pjetër Bogdani” në Ferizaj, të cilët një herë në javë shkojnë në Fabrikën e Tubave në Ferizaj dhe në ndërmarrjen e transportit “Endriti”.

Në mungesë të teksteve shkollore, mësimdhënësit e zhvillojnë lëndën mësimore duke u diktuar nxënësve, një metodë e cila nuk lë hapësirë për interaksion dhe diskutim gjatë orës mësimore. Sipas të intervistuarve të BIRN-it, 27.7% e mësimdhënësve përdorin diktimin, ndërsa në raste të tjera, përdoren skripte dhe materiale të tjera të përgatitura nga ana e mësimdhënësve (shih tabelën 25).

---

7 Intervistë me z. Hajdar Binaku, e bërë nga BIRN-i, qershor 2008

8 Debat i BIRN-it për arsimin e mesëm, i mbajtur më 9 tetor 2008

9 Takim i BIRN-it me z. Xhavit Hajdari, drejtor i Spitalit Rajonal të Gjilanit, dhjetor 2008

Hatixhe Bytyçi, nxënëse e klasës së 12-të në drejtimin e tregtisë në shkollën e mesme “Hasan Prishtina” në Mitrovicë, ka thënë se nuk ekziston asnjë tekst profesional për drejtimin e saj dhe se gjatë tërë kohës nxënësit marrin shënime.

### 3. Tekstet shkollore joadekuate

Megjithëse shkollat fillore, krahasuar me shkollat e mesme dhe sidomos me ato profesionale, janë më mirë të furnizuara me libra shkollorë, në shumë raste këto libra janë joadekuate për nivelin e caktuar të shkollimit, si dhe për moshën e nxënësve. BIRN-i ka studiuar një numër librash, ku ka vërejtur një varg mangësish në formulimin e njësisve mësimore. Në fletoren e punës së gjeografisë për klasën e gjashtë në temën “Kushtet gjeografike për zhvillimin e bujqësisë” thuhet: “Format kryesore të zhvillimit të bujqësisë janë të shumta. Dallojmë bujqësinë ekstensive dhe intensive” pa dhënë shpjegime plotësuese se çfarë është bujqësia ekstensive dhe çfarë është ajo intensive.

Sipas Xheraldina Rexhepit, kryetare e Këshillit të Prindërve në shkollën fillore “Hasan Prishtina” në Prishtinë, tekstet shkollore janë të mbingarkuara dhe aspak të kuptueshme për ta. Sipas saj, në librin e biologjisë së klasës së gjashtë, një njësi mësimore mund të ketë mbi dhjetë përkufizime me rreth 20 terma të reja, për të cilat nxënësit nuk marrin shpjegime më parë dhe të cilat nuk përsëriten më pas. “Asnjë element i ri nuk është i përfshirë në planprogramet e klasës së pestë nga klasa e katërt. Klasa e pestë është përmbledhje e klasës së katërt. Në anën tjetër, në klasën e gjashtë, janë 12 lëndë pa pasur njoftim paraprak për lëndët e reja apo ndonjë hyrje në klasën e pestë”, është shprehur Rexhepi. Sipas ekspertit të arsimit, Halim Hyseni, tekstet që përdoren në shkolla janë tradicionale, enciklopedike dhe jashtë kohës”. Se sa të ngarkuara janë këto tekste dhe joadekuate për moshën e nxënësve, sipas tij, është fakti se nxënësit e klasës së tretë të moshës tetë dhe nëntëvjeçare mësojnë për hidrokarburet.

Këtë e dëshmon edhe hulumtimi kuantitativ i BIRN-it ku nga 354 nxënësit e intervistuar lidhur me problemin më të madh me tekstet shkollore 33 (9.3%) e tyre janë përgjigjur se ato nuk janë adekuate për lëndën, 64 (18.1%) kanë thënë se tekstet shkollore nuk janë adekuate për nivelin e nxënësve, 51 (14.4%) kanë thënë se ato nuk janë sa duhet profesionale nga ana përmbajtjesore, 112 (31.6%) kanë thënë se tekstet shkollore nuk stimulojnë të menduarit kritik dhe interaksionin, ndërsa 94 (26.6%) kanë thënë se këto tekste imponojnë vetëm aktivizimin e mësimdhënësit dhe jo të nxënësit. (Shih tabelën 26)

## 4. Klasat e mbingarkuara me nxënës

Për shkak të numrit të pamjaftueshëm të shkollave dhe numrit të madh të nxënësve në to, klasat janë të mbingarkuara me nxënës. Numri i nxënësve nëpër klasa në disa raste shkon nga 45 deri 47. Për shkak të mungesës së hapësirave shkollore, shumë shkolla punojnë në dy, tri deri në katër ndërresa. Për shkak të zhvillimit të procesit mësimor në disa ndërresa, ora mësimore në disa shkolla zgjat vetëm 30 minuta.

Drejtori i Drejtorisë së Arsimit në Komunën e Gjilanit, Ismail Kurteshi, ka thënë se tri shkolla në qytetin e Gjilanit punojnë në katër ndërresa, shtatë shkolla punojnë në tri, ndërsa vetëm një shkollë punon në dy ndërresa. Asnjë shkollë në këtë komunë nuk punon në një ndërresë. Situatë e njëjtë, sipas monitoruesve të BIRN-it, është edhe në komunat e tjera.<sup>10</sup> Në shkollën e mesme bujqësore "Zenel Hajdini" në Ferizaj, ka klasë me 45 nxënës. E njëjta situatë është edhe në gjimnazin "Kuvendi i Arbrit" në Ferizaj. Gjatë vitit shkollor 2007-2008, shkolla fillore "Gjon Serreçi" në Ferizaj ka punuar në katër ndërresa, ndërsa ora ka zgjatur 25 minuta. Gjatë kësaj kohe, ka pasur klasë me mbi 50 nxënës. Problemi është zbutur gjatë vitit shkollor 2008-2009, pasi procesi mësimor zhvillohet në dy ndërresa, pasi cikli i mesëm fillor zhvillon mësimin në objektin e ish-gjimnazit "Kuvendi i Arbrit", i cili nga shtatori 2008 ka filluar punën në objektin e ri.

10 Intervistë me z. Ismail Kurteshi, drejtor i DKA-së Gjilan, dhjetor 2006

Sipas drejtorit të shkollës "Thimi Mitko" në Gjilan, z. Rabit Ademi, në këtë shkollë janë 20 klasë me mbi 40 nxënës, pesë prej të cilave kanë nga 44 nxënës. Edhe Shkolla e Mjekësisë në Gjilan gati në të gjitha klasat e 10-ta ka mbi 40 nxënës, ndërsa numri më i lartë i nxënësve në këto klasë është 45. Nga 37 shkollat fillore të Prishtinës, në një ndërresë punojnë 11 shkolla, në dy ndërresa punojnë 14 shkolla, në tri ndërresa punojnë 11 dhe në katër ndërresa punon një shkollë. Në 12 shkollat e mesme të Prishtinës, procesi mësimor zhvillohet në dy ndërresa. Nga të dhënat e Drejtorisë Komunale të Arsimit (DKA) mbi numrin e përgjithshëm të nxënësve në një vit dhe numrin e paraleleve mund të vërehet se ka klasë me më shumë se 45 nxënës. Sipas Veton Breznicës, kryetar i Këshillit të nxënësve të shkollës së mesme "28 Nëntori" në Prishtinë, në një klasë të kësaj shkolle madje ka 52 nxënës.

Sipas këtyre të dhënave, në shkollën fillore "Asim Vokshi", në klasën e parë janë 147 nxënës të ndarë në 3 paralele, që do të thotë që janë nga 49 nxënës në një klasë. Në shkollën e mesme "Sami Frashëri" në klasën e 10-të del që mesatarisht në një klasë ka 44 nxënës. Në shkollën e mesme "Xhevdet Doda" në klasën e 10-të mesatarisht në një klasë ka 45 nxënës. Krahasuar me komunat e tjera, Peja duket të jetë në pozitë më të mirë sa i përket numrit të madh të nxënësve nëpër klasë. Të gjitha shkollat e mesme dhe ato fillore në Pejë mësimin e zhvillojnë në dy ndërresa, ndërsa sipas të dhënave të DKA-s, nuk ka klasë me 45 nxënës. Në qytetin e Mitrovicës vetëm një shkollë punon në një ndërresë, procesi mësimor në dy ndërime zhvillohet në dymbëdhjetë shkolla, gjashtë shkolla punojnë në tri ndërresa, ndërsa në katër ndërresa nuk punon asnjë shkollë.

Nga 354 nxënësit e intervistuar, 18 (5.1) e tyre kanë thënë se mësimi në shkollën e tyre zhvillohet në një ndërresë, 191 (54.0%) kanë thënë se mësimi në shkollën e tyre mbahet në dy ndërresa, 130 (36.7%) kanë thënë se mësimi mbahet në tri ndërresa, ndërsa 15 (4.2%) kanë thënë se mësimi në shkollat e tyre mbahet në katër ndërresa. (Shih tabelën 9)

## 5. Dhuna në shkolla

Në Kosovë, nxënësit i nënshtrohen dhunës nga ana e mësimitdhënësve të tyre. Për të pasqyruar shkallën e dhunës nga ana e mësimitdhënësve nëpër shkolla, BIRN-i ka intervistuar shumë nxënës, të cilët, madje, kanë identifikuar mësimitdhënësit të cilët përdorin dhunë ndaj nxënësve. Tridhjetë nxënës të intervistuar në Prishtinë kanë thënë se në shkollën e tyre përdoret dhuna nga një numër i mësimitdhënësve. Një dhunë e tillë është pasqyruar edhe në një reportazh të përgatitur nga BIRN-i për dhunën e ushtruar ndaj nxënësve në fshatin Gjurkocv të Komunës së Shtimes, ku si pasojë e kësaj një nxënës ka kërkuar trajtim mjekësor.

Raporti i javës së dytë të dhjetorit të monitorueses së BIRN-it, bazohet tërësisht në deklaratat e nxënësve të shkollave fillore: “Shkëndija” në Hajvali, “Dardania” në Prishtinë dhe “Hasan Prishtina” në Prishtinë. Nxënësit e intervistuar në këto shkolla kanë përmendur me emra gjashtë mësimitdhënës të këtyre shkollave të cilët përdorin dhunë të madhe ndaj nxënësve.

Njëmbëdhjetë nxënës të intervistuar në Prishtinë gjithashtu kanë theksuar edhe dhunën e ushtruar nga rrugaçët, të cilët shumë shpesh kërcënojnë dhe sulmojnë nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme, si dhe të rasteve të dhunës ndërmjet nxënësve.

Tre nxënës të shkollës fillore “Skënderbeu” në fshatin Vaganicë të Mitrovicës kanë deklaruar se në shkollën e tyre ushtrohet dhunë nga pothuajse të gjithë mësimitdhënësit, madje edhe nga drejtoresha. Me ardhjen e drejtorit të ri në këtë shkollë, Xhelal Tahiri, i ka dhënë vërejtjen e fundit me shkrim një mësimitdhënësi të kësaj shkolle për shkak të përdorimit të dhunës. Tetë nxënës të shkollave në Ferizaj kanë deklaruar se në shkollat e tyre ushtrohet dhunë nga ana e mësimitdhënësve. Gjashtë nxënës të shkollave fillore në Pejë kanë deklaruar se ndaj tyre ushtrohet dhunë nga ana e mësimitdhënësve të shkollës, ndërsa katër të tjerë kanë thënë se ka dhunë edhe midis nxënësve. Në përgjithësi, moni-

toruesit e BIRN-it kanë raportuar për afro 60 raste të dhunës, të cilat përfshijnë dhunën e mësimdhënësve ndaj nxënësve dhe dhunën midis vetë nxënësve.

Gjatë intervistës me drejtorin e shkollës fillore "Hasan Prishtina", Shyqri Obërtinca, në Prishtinë, monitoruesja ka parë një numër thikash, të cilat, sipas Obërtincës, u janë marrë nxënësve. Gjatë intervistës me përfaqësuesit e Këshillit të Nxënësve të Prishtinës, Isa Morina, Valon Bytyçi dhe Samir Zullani, është theksuar se mungesa e sigurisë është një ndër problemet më të mëdha të nxënësve. Për këtë arsye, nxënësit e shkollës së mesme "Gjin Gazulli" në Prishtinë paguajnë çdo muaj nga tri euro për rojën e shkollës. Nga pesë euro për sigurim të shkollës kanë paguar edhe nxënësit e shkollës së mesme "Bedri Pejani" në Pejë.

Edhe nxënësit e shkollës fillore "Hasan Prishtina" në Prishtinë kanë pohuar se ndihen vazhdimisht të kërcënuar nga rrugaçët, të cilët i detyrojnë ata madje t'u japin para. Gjatë monitorimit në shkollën fillore "Zenel Hajdini" në Prishtinë, monitoruesja e BIRN-it ka parë përlëshjen ndërmjet dy grupeve të nxënësve, të cilët kanë përdorur thika dhe mjete të tjera të rrezikshme. Tre nxënës janë lënduar gjatë një përlëshjeje në shkollën e mesme teknike në Prishtinë në prill të vitit 2009. Njëri nga sulmuesit ka qenë ish-nxënës i shkollës, i cili për shkak të sjelljeve të këqija ishte përjashtuar kohë më parë.

Me gjithë problemet e tilla, në 18 raste (5.1%) rojë bën sigurimi civil, në 23 raste (6.5%) nuk ka fare rojë në shkolla, në 16 raste (4.5%) rojë bëjnë vetë nxënësit, ndërsa në 297 raste (83.9%) sigurimin e shkollës e bën stafi teknik i shkollës (shih tabelën 3).

Përveç mungesës së psikologëve në shkolla, një faktor që i kontribuon kësaj shkalle të lartë të dhunës është edhe mungesa e pajisjeve që mundësojnë aktivitetin fizik dhe rekreativ të nxënësve. Nga 354 nxënësit e intervistuar, 101 (28.5%) prej tyre kanë thënë se shkollat e tyre nuk janë të furnizuara me mjete dhe rekuizita sportive, 133 (37.6) kanë thënë se shkollat e tyre janë të pajisura dobët, 65 (18.4) kanë thënë se janë të furnizuara mesatarisht, 51 (14.4%) kanë thënë se janë të furnizuara mirë, ndërkaq vetëm 4 (1.1%) kanë thënë se shkollat janë të furnizuara shumë mirë me pajisjet sportive. (Shih tabelën 28).

Me gjithë shkallën e lartë të dhunës nëpër shkolla, bashkëpunimi me prindër nuk duket të jetë shumë i kënaqshëm. Në disa shkolla mbledhjet mbahen tepër rrallë. Valbona Kastrati, drejtoreshë e shkollës “Meto Bajraktari”, kishte organizuar mbledhjet me prindër, të cilat nuk ishin mbajtur për më tepër se një vit para ardhjes së saj si drejtoreshë në këtë shkollë. Një gjë e tillë është pohuar edhe nga Hajdar Binaku, drejtor i shkollës së mesme teknike “28 Nëntori”. Sipas tij, prindërit janë shumë pasivë dhe shumica e tyre nuk marrin pjesë në mbledhjet e prindërve. Mosbashkëpunimi mësimdhënës – prindër është në nivel shumë të lartë edhe në shkollën “Elena Gjika” në Mitrovicë. Kështu ka deklaruar Suzana Hyseni, drejtoreshë e kësaj shkolle.

Nga 354 personat e intervistuar, 12 prej tyre (3.4%) kanë thënë se bashkëpunimi mësimdhënës – prindër është shumë i keq, 60 prej tyre (16.9%) ka thënë se ky bashkëpunim është i keq, 132 (37.3%) e kanë vlerësuar këtë bashkëpunim si mesatar, 122 (34.5%) si të mirë, 28 (7.9%) si shumë të mirë. (Shih tabelën 17).

## 6. Përdorimi i drogës në shkollë

Gjatë monitorimit, monitoruesit e BIRN-it kanë siguruar të dhëna edhe për përhapjen e dukurisë së përdorimit të drogës nëpër shkollat e mesme dhe në disa raste edhe në shkolla fillore. Një gjë e tillë është pohuar nga nxënës të shkollës “Sami Frashëri” në Prishtinë, nxënës të shkollës “Shaban Spahija” në Pejë dhe nxënës të shkollës së mesme në Fushë-Kosovë. Këta nxënës madje kanë treguar se si dhe ku blihet ajo. Një nga shkollat më të prekura është raportuar të jetë shkolla e mesme “Sami Frashëri” në Prishtinë. Nxënës të kësaj shkolle kanë pohuar se në shkollën e tyre përdoret në masë të madhe marihuana, si diçka normale, ndërsa, sipas tyre, ka raste edhe të përdorimit të drogave më të rënda si kokaina. Nxënësit e shkollës së mesme në Fushë-Kosovë kanë thënë se disa nga nxënësit e kësaj shkolle blejnë drogë afër Stacionit Hekurudhor në Fushë-Kosovë.

Rritja e ndjeshme e përdoruesve të drogës te të rinjtë është konfirmuar edhe nga policia dhe organizatat joqeveritare, të cilat merren me trajtimin psikologjik të personave të varur nga droga dhe me informimin e të rinjve për pasojat e përdorimit të drogës, që është bërë nëpërmjet mbajtjeve të punëtorive nëpër shkolla.<sup>11</sup>

Kjo temë është trajtuar edhe një reportazh dhe debat të BIRN-it.<sup>12</sup> Nxënësit e intervistuar kanë pohuar se droga shitet dhe ofrohet nga vetë disa nxënës, të cilët shërbejnë si agjentë të shitjes nga persona të tjerë jashtë shkollës. Me gjithë shkallën e lartë të dhunës dhe të përdorimit të drogës, dy dukuri gjithnjë në rritje, në 23% të shkollave nuk ofrohet përkrahje psiko-sociale, ndërsa në 31.9% të shkollave një gjë e tillë ofrohet nga stafi i shkollës, i cili nuk është i specializuar për një gjë të tillë (shih tabelën 11).

Duke pasur parasysh se në Kosovë mungojnë edhe qendrat, të cilat merren me trajtimin psiko-social të nxënësve me sjellje josociale dhe agresive, problemi i mungesës së psikologëve nëpër shkolla bëhet edhe më i madh. Sikurse edhe në rastin e dukurisë së dhunës nëpër shkolla, mungesa e aktivitetit fizik dhe bashkëpunimi në nivel jo të kënaqshëm ndërmjet prindërve dhe mësimitdhënësve janë faktorë që i ka kontribuar përhapjes së kësaj dukurie.

## 7. Mësimdhënësit mbajnë kurse private

Shumë mësimdhënës të shkollave fillore dhe të atyre të mesme mbajnë kurse private të lëndëve, të cilat ata u japin në shkollë nxënësve të tyre. Normalisht, nxënësit paguajnë për këto kurse, të cilat mbahen në shkollë apo në shtëpitë e mësimdhënësve.

11 Qendra "Labirinthi" me qendër në Prishtinë dhe "Fëmijët kosovarë dhe evropianë për të drejtat e tyre" me qendër në Prizren.

12 Raport televiziv i transmetuar në debatin "Jeta në Kosovë", më 5 shkurt 2009

Shumë nxënësve kanë thënë se kjo ndikon në procesin e vlerësimit me nota nga ana e mësimit nxënësve. Sipas tyre, nxënësit që vijojnë këto kurse marrin nota më të larta, ndonëse janë më të papërgatitur se nxënësit e tjerë.

Nxënës të shkollës fillore "Dardania" në Prishtinë kanë treguar për mbajtjen e kurseve private të gjuhës angleze nga arsimtarja L.K., e cila, sipas tyre, i favorizonte nxënësit të cilët vijonin kursin privat të mbajtur nga ajo. Raste të shpeshta të mbajtjes së kurseve private nga ana e mësimit nxënësve janë raportuar edhe nga shkollat e tjera. Nxënës të shkollës së mesme "Sami Frashëri" kanë thënë se mësimit nxënësi A.J. mban kurse të matematikës, për të cilin nxënësit paguajnë 20 euro në muaj.

Në shtatë raste, nxënësit e intervistuar në Prishtinë nga BORN-i kanë pohuar se disa mësimit nxënës në shkollat e tyre mbajnë kurse private. Kurse private mbahen edhe nga disa mësimit nxënës të gjimnazit "Kuvendi i Arbrit" në Ferizaj" dhe të shkollës fillore "Ahmet Hoxha" ku nxënësit paguajnë 10 deri 20 euro në muaj. Në Pejë, kurse private mbahen nga mësimit nxënës të shkollës "Lidhja e Prizrenit", ndërsa pagesa mujore është 10 euro në muaj. Nxënësja e kësaj shkolle, V.D., ka thënë se vijimi i këtij kursi është pothuajse i obligueshëm, pasi nxënësit që nuk i vijojnë ato vlerësohen me nota të dobëta.

## 8. Mosmbajtja e orëve të mësimit

Për shkak të reduktimeve të energjisë elektrike, procesi mësimit nuk zhvillohet rregullisht. Në këtë mënyrë preken nxënësit të cilët mësimit e zhvillojnë në ndërresën e pasdites. Një ndër shkollat, e cila ka humbur më së shumti orë mësimit, është shkolle "Hasan Prishtina" në Prishtinë. Sipas Xheraldina Rexhepit, nënë e dy nxënësve, të cilat vijojnë mësimit në këtë shkolle, gjatë dimrit nxënësit e pasdites në të shumtën e rasteve nuk kanë zhvilluar mësimit. Në cilësinë e kryetares së Këshillit të Prindërve të kësaj shkolle, ajo ka pohuar të ketë kontaktuar edhe Drejtorinë Komunale të Arsimit, nga ku ka marrë informatë se nuk

ka fonde për rregullimin e gjeneratorit të shkollës. Hamdi Shyti, drejtor i shkollës "Migjeni" në Mitrovicë, ka thënë se gjatë dimrit nxënësit e kësaj shkolle, të cilët vijojnë mësimin në ndërresën e pasdites kanë humbur shumë orë mësimore për shkak të mungesës së energjisë elektrike. Një gjë të tillë e ka pohuar edhe Faik Berisha, drejtor i shkollës "Afrimi dhe Fahriu" në fshatin Lluzhan të Komunës së Podujevës. Ndryshe nga këto raste, nxënësit e shkollës së mesme teknike në Ferizaj, sipas zëvendësdrejtorit të shkollës, Imri Musliu, humbin orët e mësimin për shkak të ritualeve fetare (faljes) të mësimdhënësve të tyre.

Rasti më drastik i mosmbajtjes së orëve të mësimin është shënuar në fillim të vitit shkollor 2008-2009 në shkollën fillore "Hasan Prishtina" në Prishtinë, ku mësimi ka filluar me një vonesë prej tri javësh. Sipas drejtorit të shkollës, Shyqeri Obërtinca, një gjë e tillë ka ndodhur për shkak të renovimit të shkollës, por edhe për arsye se konfuzionit të krijuar rreth transferimit të një pjesë të nxënësve të kësaj shkolle në shkollën e re të ndërtuar në Lagjen e Spitalit.

## 9. Papastërtia në institucionet shkollore

Me gjithë numrin e madh të nxënësve dhe reduktimet e vazhdueshme të ujit, në shkollat e Kosovës nuk ka rezervuarë uji. Reduktimet e ujit madje mund të zgjasin edhe nga dy-tri ditë, si në rastin e shkollës "Zeinel Salihu" në fshatin Bardh i Madh i Komunës së Prishtinës.<sup>13</sup> Shkolla "Zahir Pajaziti" në fshatin Orllan madje nuk është e lidhur fare në sistemin e ujësjellësit.<sup>14</sup>

Në mbi 50 % të shkollave të monitoruara, ekziston një nivel jo i kënaqshëm i pastërtisë në klasa, korridore dhe kabinete. Kjo përqindje bie akoma më shumë në rastin e pastërtisë së tualeteve ku nga 354 përgjigje, 60.5% e tyre flasin

13 Intervistë me Ismet Bajçincën, drejtor i shkollës "Zeinel Salihu" në fshatin Bardh i Madh.

14 Intervistë me Muharrem Hoxhën, drejtor i shkollës "Zahir Pajaziti" në fshatin Orllan, dhjetor 2008.

për nivel shumë të ulët pastërtisë, ndërsa 98 (27.7%) e përgjigjeve flasin për një nivel mesatar të pastërtisë, ndërsa 29 (8.2%) e këtyre përgjigjeve thonë se në shkollë ka nivel të lartë të pastërtisë, ndërsa vetëm 6 përgjigje (1.7%) thonë se pastërtia në tualetet e shkollës është në nivel shumë të lartë (shih tabelat 4, 5, 6 dhe 7).

## 10. Testi i maturës

Niveli i ulët i njohurive të nxënësve të shkollave të mesme është vërtetuar edhe me rastin e testit të maturës. Në qershor të vitit 2008, nga 20.072 nxënës, testin e maturës e kanë kaluar 9.017 nxënës (44.7%). Shkalla e kalueshmërisë me këtë rast ka qenë 50%.

Disa ditë pas rezultatit të testit të maturës, MASHT-i mori vendim për uljen e shkallës së kalueshmërisë në 45% dhe me këtë rast u mundësua që nga 9.017, testin e maturës ta kalojnë 12.049 nxënës, ndërsa në afatin e dytë të mbajtjes së testit të maturës, këtë test e kanë kaluar edhe 6.085 nxënës të tjerë.

Megjithëse janë përpiluar gjashtë lloje të testeve, shumë shkolla profesionale janë diskriminuar si: shkolla e mjekësisë, teknike, tregtisë, turizmit, bujqësisë, inxhinierisë, tekstilit, medresetë etj., pasi në teste, numri më i madh i pyetjeve nuk kanë pasur të bënin me këto drejtime. "Sipas planprogrameve mësimore, të hartuara nga MASHT-i, nga 32 orë në javë, 17 janë nga lëndët profesionale, gjashtë prej tyre mësim praktik, ndërsa nxënësit i nënshtrohen një testi të lëndëve të përgjithshme", ka thënë Izija Mjekiqi, profesor i lëndëve elektroteknike në Shkollën e Mesme në Obiliq.<sup>15</sup>

Gjithashtu me testin e maturës janë diskriminuar nxënësit e shkollave të mesme, të cilët mësimin e zhvillojnë në gjuhën angleze. Aktualisht në Kosovë janë dy shkolla të tilla: "Shkolla Amerikane e Kosovës", nxënësit e së cilës kanë hyrë në

---

15 Deklaratë e z. Izija Mjekiqi, në debatin e BIRN-it për arsimin e mesëm, 9 tetor 2008.

testin e maturës dhe shkolla “Mehtmet Akif”, nxënësit e së cilës i janë nënshtruar testit të maturës për Gjinnazin e Shkencave Natyrore.

Në vazhdim janë gjashtë llojet e testeve të maturës sipas orientimit të shkollës.

- Testi i maturës për gjinnazin e përgjithshëm;
- Testi i maturës për gjinnazin e gjuhëve;
- Testi i maturës për gjinnazin e shkencave shoqërore;
- Testi i maturës për gjinnazin e shkencave natyrore;
- Testi i maturës për gjinnazin matematikë - informatikë;
- Testi i maturës për arsimin profesional.

Lidhur me parregullsitë gjatë mbajtjes së testit të maturës, Ismet Potera, drejtor i Institutit Pedagogjik të Kosovës, si cili e ka monitoruar procesin, ka thënë së në disa komuna mësimdhënësit i kanë plotësuar testet në vend të nxënësve, në mënyrë që të mbulonin mospunën e tyre. Potera, gjithashtu, ka thënë se ka pasur ndërhyrje të drejtorive komunale që t’u jepej ndihmë nxënësve gjatë testit, në mënyrë që të mos dalin rezultate negative në atë komunë.<sup>16</sup> Nxënësi Ardit Gashi, nga Ferizaj, i cili i është nënshtruar këtij testi, gjithashtu ka thënë se ka pasur shumë parregullsi gjatë mbajtjes së testit. Ai ka thënë se testet kanë arritur në klasë me vonesë, duke ua kufizuar kohën nxënësve për ta plotësuar testin. Gashi ka thënë se ka pasur tolerancë të tepruar të monitoruesve në klasë. “E tërë klasa jonë ka kopjuar. Ndërsa në paralelen tjetër, monitoruesi u ka thënë nxënësve që të mos u përgjigjen pyetjeve nga ekonomia dhe informatika se do t’ua sjellim përgjigjet në klasë, dhe përgjigjet janë ardhur”, ka thënë Gashi.<sup>17</sup>

16 Deklaratë e Ismet Poterës në debatin e BIRN-it “Kualiteti i arsimit në Kosovë”, 3 korrik 2008

17 Deklaratë e Ardit Gashit në debatin e BIRN-it „Kualiteti i arsimit në Kosovë”, 3 korrik 2008

Por, ajo që ka vërejtur BIRN-i është se me rastin e këtij testi, ka pasur disa gabime në përpilimin e tij. P.sh., pyetja në gjuhën angleze:

1. Choose the correct answer to complete the question:  
Of all the fruit I like \_\_\_\_\_ best because it's so juicy.

- A. a orange
- B. an orange
- C. orange
- D. the orange

Kjo pyetje mund të shkaktojë konfuzion te nxënësit, pasi në vend të fjalës sentence (fjalë), është përdorur fjala question (pyetje).

2. Which word is different?

- |           |          |
|-----------|----------|
| A. bright | E. bring |
| B. tight  | F. swing |
| C. right  | G. wing  |
| D. fight  | H. cling |

Kjo pyetje është bërë pa u sqaruar asgjë nxënësve. Në formën e parashtruar pyetja nuk e specifikon se në bazë të çfarë kriteri duhet të identifikohet fjala që dallon nga fjalët e tjera. Thjesht, nuk dihet a kërkohet fjala e ndryshme, e cila dallon në kuptim, shqiptim apo në aspektin morfologjik/fonetik, etj.

3. In the words given below the underlined letter(s) pronounced in the same way EXCEPT in one. Which one?

- A. enough
- B. though
- C. though
- D. rough

Te kjo pyetje, dy nga opsionet B dhe C janë të njëjta dhe kjo mund të shkaktojë konfuzion tek nxënësit.

Një gabim teknik, i cili gjithashtu mund të ketë ndikuar në dhënien e përgjigjes së pasaktë apo të mospërgjigjes nga ana e nxënësve ka të bëjë me pyetjen 66 të testit A të gjimnazit të gjuhëve: ku figura e detyrës që duhet të kryhet nga nxënësit është në faqen paraprake.

Në testin e maturës gjithashtu janë parashtruar pyetje subjektive, siç është pyetja në gjuhën shqipe ku nxënësve u jepet një pasazh, të cilit nxënësit duhet t'i vënë një titull.

Pasazhi:

Dola jashtë qytetit, përtej Urës së Bahçallekut. Fillova me recitue: “Përmbi lumë të Babilonit, atje ndejem dhe lotueme, kah na shkonte malli i Sionit”. Ecëshem i vetmuem. U mendojshem me e shpejtue hapin, që të mos më xajë nata në rrugë. Por nata mue me kishte xanë, nata e mendjes. Un nuk dijshem ma se kah me ia mbajtë. Ku jam? Ku shkoj? Aty? Atje? Ku? Ç’do të baj?

E ndjeva vedin se nuk ishem kurrëgjia tjetër por një tullumbac në hava që sillet në atë drejtim që ta çojë era. E shka asht era? A thue asht vet jeta? Trishtim i madh! O zot, rri me ne se asht kah erret!

Pyetja:

Titulli më i përshtatshëm për pjesën e parë (pasazhin e mësipërm) do të ishte:

- A. Nata e mendjes;
- B. Fillova me recitue;
- C. Mbi lumë të Babilonit;
- D. Kah me ja mbajtë.

Pyetja është shumë subjektive, meqë pas leximit të pasazhit, duhet të vendoset titulli më i përshtatshëm, që do të mund t'i vendosej pasazhit. Në pasazh nuk ka ndonjë tregues të qartë, i cili do të mund të determinonte apo favorizonte njërin nga titujt e ofruar. Përgjigjja mund të jepet varësisht nga mënyra e gjykimit të nxënësit.

## 11. Parregullsitë në punësimin e stafit të shkollave

1. Gjatë monitorimit të shkolla të mesme dhe të atyre fillore, BIRN-i ka hasur në disa raste, ku punësimi i drejtorëve dhe i sekretarëve të shkollave është bërë në mënyrë jo të rregullt. Haki Dili, tre vjet më parë ishte zgjedhur drejtor i shkollës së mesme të tregtisë dhe hotelerisë “7 Shtatori” në Prishtinë, gjë që kishte nxitur reagimin e kundërkandidatit Bajram Islami, i cili kishte dorëzuar ankesën te Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Kosovës (KPMK), i cili dy vjet më pas kishte konstatuar se lidhur me rastin në fjalë kishte pasur parregullsi dhe se Bajram Islami i kishte plotësuar kriteret për drejtor. Por edhe pas shpalljes së konkursit të ri, Dili ishte zgjedhur përsëri drejtor i shkollës, ndonëse Islami kishte përvojë 30-vjeçare në arsim dhe si drejtor, ndërkaq Dili nuk kishte përvojë menaxheriale dhe shumë më pak përvojë në arsim. MASHT-i më këtë rast nuk i kishte përfillur gjetjet dhe konstatimet e KPMK-së.

2. Në shkollën e mesme bujqësore “Abdyl Frashëri” në Prishtinë, kishte ekzistuar sekretari i shkollës Xhevdet Gashi, i cili ishte punësuar në këtë shkollë që nga 1 nëntori i vitit 2006. Ndonëse kishte kontratën tjetër të vazhduar nga 1 shtatori 2007 deri më 31 gusht 2008, në janar të vitit 2008 Drejtoria Komunale e Arsimit ka angazhuar edhe një sekretar tjetër, Faik Azemin, i pranuar pa konkurs, me kontratë nga 1 janari 2008 deri më 31 gusht, pa miratimin e drejtorit të shkollës. Përveç shkeljes së parë të bërë me punësimin e Azemit pa iu nënshtruar procedurës së rregullt të konkursit, në kontratën e tij, të nënshkruar nga drejtori i atëhershëm i DKA-së, Rustem Buzhala, nuk është i shënuar fare “nr. i regjistrimit të punëtorit”, të cilin duhet ta ketë çdo punëtor i shërbimeve publike. Madje, në kontratë nuk është i shënuar fare as emri i shkollës, në të cilën angazhohet ky sekretar. Për dallim nga Gashi, i cili në listën zyrtare të pagave e ka pagën mujore 215 euro dhe ka thirrjen si sekretar i shkollës së mesme, Azemi e ka pagën 205 euro dhe pozitën sekretar i shkollës fillore, megjithëse shkolla ku është angazhuar është shkollë e mesme. Kundër kësaj parregullsie ka

reaguar drejtori i shkollës Nexhmi Leci, i cili ka bërë ankesë më 12 shkurt 2008 dhe ia ka dorëzuar ushtruesit të detyrës së drejtorit të DKA-së, Halim Halimi. Ky i fundit nuk ka ndërmarrë asgjë, prandaj sekretari i dytë ka marrë pagë për dy muajt e parë të këtij viti. Sapo është zgjedhur drejtori i ri i DKA-së, Agim Gashi, drejtori i shkollës Nexhmi Leci ia ka dërguar të njëjtën ankesë dhe është marrë vendim që sekretari i dytë të largohet. Rrjedhimisht, sekretari i dytë nuk gjendet në listën e pagave për muajin mars. Megjithatë, drejtori i shkollës, Nexhmi Leci, i ka thënë BIRN-it<sup>18</sup> se ky person është futur sërish në listën e pagave të kësaj shkolle për muajin prill, por tash si mësimdhënës me normë të plotë, me gjithë faktin se ai nuk ka dhe nuk mban asnjë orë në këtë shkollë. Drejtori i shkollës ka reaguar sërish dhe është takuar me drejtorin e DKA-së, nga i cili ka kërkuar sqarime. Agim Gashi i ka thënë drejtorit të shkollës që ky person ka hyrë në listën e pagave me kërkesë të Halim Halimit, që aktualisht është Shef i Administratës në KK të Prishtinës (më parë ka qenë për një kohë ushtrues detyre i drejtorit të DKA-së). Megjithatë, më pas drejtori i shkollës, Nexhmi Leci, ka bërë të ditur se në listën e pagave të muajit prill figuron si sekretar i shkollës Faik Azemi, ndërsa sekretari i mëhershëm Xhevdet Gashi figuron si mësimdhënës me 19 orë mësimi, ndonëse ai nuk ka dhe nuk mban asnjë orë mësimi, sepse nuk ka orë të lira për të. Drejtori ka thënë se sekretari i ri, Faik Azemi, nuk vjen fare në shkollë dhe nuk kryen kurrfarë pune. (BIRN-i ka siguruar dokumentacionin lidhur me këtë rast<sup>19</sup>).

18 Intervistë me z. Nexhmi Leci, drejtor i shkollës "Abdyl Frashëri" e bërë më 15 prill, 2008

19 Dokumentacioni i siguruar nga BIRN-i përfshin:

1. Listën e pagave të punonjësve të shkollës "Abdyl Frashëri" për muajt janar, mars dhe prill 2008
2. Kontratën e parë dhe të dytë të sekretarit të parë Xhevdet Gashi
3. Kontratën e sekretarit të dytë, Faik Azemi

3. Në muajin mars të këtij viti, Departamenti Komunal i Arsimit në Prizren shpalli konkurs për pozitën e drejtorëve në të gjitha shkollat fillore dhe në ato të mesme të Komunës së Prizrenit, megjithëse një pjesë prej tyre kontrata u përfundon në vitin 2010. BORN-i intervistoi dy nga drejtorët e tanishëm, Nazrie Aliarifi, drejtoreshë e shkollës fillore "Emin Duraku" në Prizren, dhe Ridvan Hoxha, drejtor i shkollës së mesme të mjekësisë në Prizren, të cilët shprehën dyshimet se një gjë e tillë është bërë me motive politike. Derisa Aliarifi thotë të mos jetë anëtare e asnjë partie, Hoxha është nënkryetar i Degës së Lidhjes Demokratike të Kosovës në Prizren. Kontrata e punës për z. Hoxha zgjat deri më 31.01.2010. BORN-i ka intervistuar edhe Florin Metaj drejtor komunal i arsimit në Prizren, i cili ka theksuar se shpallja e konkursit nuk përbën shkelje ligjore. Megjithatë, ai ka thënë se shumica e drejtorëve dhe e zëvendës drejtorëve janë aktivistë të LDK-së, por ka shtuar se kjo nuk ka qenë arsyeja e shpalljes së konkursit. Sipas tij, qëllim i shpalljes së konkursit ka qenë përmirësimi i gjendjes në arsim në Komunën e Prizrenit. Pas ankesave të shumta të drejtorëve aktualë, drejtuar Kuvendit të Kosovës, Presidencës, ICO-s dhe ambasadave të huaja në Kosovë, konkursi është anuluar për pozitat e drejtorëve në ato shkolla, ku drejtorët aktualë kanë kontratë deri në vitin e ardhshëm.

# REKOMANDIME

Për MASHT-in:

1. Të bëhet ndryshimi i Urdhëresës administrative 50/04, e cila e ndalon përsëritjen e klasës nga nxënësit nga klasa e parë deri në të gjashtë.
2. Të rritet numri i inspektorëve dhe prania më e madhe e tyre gjatë orëve mësimore, për të vlerësuar kualitetin e mësimdhënies nga ana e mësimdhënësve.
3. Të bëhet aftësim profesional i vazhdueshëm për mësimdhënësit që mund të arrihet përmes trajnimeve.
4. Të bëhet përpilimi i teksteve adekuate mësimore për shkollat profesionale.
5. Të sigurohet puna praktike për nxënësit e shkollave profesionale, gjë që mund të arrihet nëpërmjet marrëveshjeve me ndërmarrjet private.
6. Të analizohen tekstet aktuale sidomos për nivelin fillor dhe atë të mesëm të ulët, zëvendësimi i tyre me tekste të reja adekuate dhe harmonizimi i tyre me moshën e nxënësve.
7. Të ndërtohen objekte të reja shkollore nëpër qytete, në mënyrë që të zbutet problemi i ngarkesës me nxënës nëpër klasa.
8. Të punësohen psikologë nëpër ato shkolla të cilat aktualisht nuk kanë psikologë, në mënyrë që të punohet me nxënës problematikë dhe me ata që marrin drogë.
9. Të punësohen roja nëpër shkolla, në mënyrë që të evitohen rastet e dhunës ndërmjet nxënësve dhe ato ndërmjet nxënësve dhe personave jashtë shkollës.
10. Të nxirret një rregullore për shkollat për ndalimin e mbajtjes së kurseve private nga ana e mësimdhënësve dhe marrja e masave ndaj atyre që e bëjnë një gjë të tillë.
11. Të sigurohen gjeneratorë nëpër shkollat, të cilat zhvillojnë mësimin me ndërresa, në mënyrë që të evitohen humbjet e orëve të mësimin për shkak të mungesës së energjisë elektrike.
12. Të sigurohen rezervuarë uji nëpër shkolla, në mënyrë që të ketë një

nivel më të lartë të pastërtisë në institucionet shkollore.

13. Të bëhet profilizimi i testit të maturës sipas drejtimeve, në mënyrë që ky test të jetë në përputhje me programet e zhvilluara nga nxënësit.
14. Zbatimi i standardeve ligjore për numrin e nxënësve nëpër klasa në shkollat e të gjitha niveleve.

### Për drejtorët e shkollave:

1. Të bëhet vlerësim sistematik i mësimdhënësve për punën e tyre dhe inspektim i brendshëm për të parë përgatitjen e mësimdhënësve gjatë orëve të mësimi.
2. Të bëhet kontroll më i rreptë ndaj vlerësimit dhe notimit të nxënësve nga ana e mësimdhënësve.
3. Të krijohen komisione për vlerësimin e nxënësve.
4. Të ndalohen kurset private nga ana e mësimdhënësve dhe të merren masa ndaj atyre që e bëjnë një gjë të tillë.
5. Të angazhohen për të gjetur mundësi për punë praktike për nxënësit sidomos për nxënësit e shkollave profesionale, duke bërë marrëveshje me kompani dhe ndërmarrje private.
6. Zbatimi i ligjit nga MASHT-i dhe DKA e arsimit gjatë zgjedhjes së drejtorëve të shkollave, sidomos kërkesa që çdo drejtor të jetë i aftësuar dhe i certifikuar për qeverisje, udhëheqje dhe vlerësim.

### Për mësimdhënësit:

1. Harmonizimi i kriterëve për vlerësimin e nxënësve me theks të posaçëm në eliminimin e dallimeve ekstreme midis vlerësimit të nxënësve në gjysmëvjetorin e parë dhe në gjysmëvjetorin e dytë.
2. Të bëhet përcaktimi i kriterëve më të rrepta për vlerësimin e nxënësve, sidomos në gjysmëvjetorin e dytë.
3. Të gjinden forma të tjera bashkëpunimi me prindër, përveç atyre formale (mbledhjeve me prindër), në mënyrë që të zvogëlohen dukuritë siç janë shkalla e lartë e dhunës dhe përdorimi i drogës nga ana e nxënësve.

## Për prindërit:

1. Të kenë pjesëmarrje të rregullt në mbledhjet e prindërve, si dhe bashkëpunim më të ngushtë me mësimdhënës nëpërmjet formave të tjera joformale.

## Për departamentet komunale të arsimit:

1. Rritje e autonomisë së drejtorëve në menaxhimin e buxhetit të shkollave.
2. Furnizim më i mirë dhe më i rregullt i shkollave me inventar, me mjete higjienike dhe me material të nevojshëm shkollor.

# Tabelat me të dhënat e pyetësorëve për sistemin arsimor

## Niveli i shkollës

|       |                 | Frekuenca | Përqindja |
|-------|-----------------|-----------|-----------|
| VALID | Shkollë fillore | 247       | 69.8%     |
|       | Shkollë e mesme | 107       | 30.2%     |
|       | Total           | 354       | 100.0%    |

Tabela 1

## Rajoni

|       |           | Frekuenca | Përqindja |
|-------|-----------|-----------|-----------|
| VALID | Prishtinë | 221       | 62.4%     |
|       | Gjilan    | 2         | 0.6%      |
|       | Ferizaj   | 32        | 9.0%      |
|       | Mitrovicë | 63        | 17.8%     |
|       | Pejë      | 36        | 10.2%     |
|       | Total     | 354       | 100.0%    |

Tabela 2

A ka shkolla njerëz përgjegjës (rojë) në hyrje të institucionit?

|       |                                     | Frekuenca | Përqindja |
|-------|-------------------------------------|-----------|-----------|
| VALID | Nuk ka fare rojë                    | 22        | 6.5%      |
|       | Rojë bëjnë mësuesit kujdestarë      | 16        | 4.5%      |
|       | Rojë bëjnë stafit teknik i shkollës | 297       | 83.9%     |
|       | Rojë bëjnë sigurimi civil           | 18        | 5.1%      |
|       | Total                               | 354       | 100.0%    |

Tabela 3

Niveli i pastërtisë në oborr?

|       |                                   | Frekuenca | Përqindja |
|-------|-----------------------------------|-----------|-----------|
| VALID | Niveli shumë i ulët i pastërtisë  | 9         | 2.5%      |
|       | Niveli i ulët i pastërtisë        | 52        | 14.7%     |
|       | Niveli mesatar i pastërtisë       | 198       | 55.9%     |
|       | Niveli i lartë i pastërtisë       | 89        | 25.1%     |
|       | Niveli shumë i lartë i pastërtisë | 6         | 1.7%      |
|       | Total                             | 354       | 100.0%    |

Tabela 4

### Niveli i pastërtisë në korridore?

|       |                                   | Frekuenca | Përqindja |
|-------|-----------------------------------|-----------|-----------|
| VALID | Niveli shumë i ulët i pastërtisë  | 4         | 1.1%      |
|       | Niveli i ulët i pastërtisë        | 37        | 10.5%     |
|       | Niveli mesatar i pastërtisë       | 137       | 38.7%     |
|       | Niveli i lartë i pastërtisë       | 163       | 46.0%     |
|       | Niveli shumë i lartë i pastërtisë | 13        | 3.7%      |
|       | Total                             | 354       | 100.0%    |

Tabela 5

### Niveli i pastërtisë në klasë/kabinete?

|       |                                   | Frekuenca | Përqindja |
|-------|-----------------------------------|-----------|-----------|
| VALID | Niveli shumë i ulët i pastërtisë  | 9         | 2.5%      |
|       | Niveli i ulët i pastërtisë        | 58        | 16.4%     |
|       | Niveli mesatar i pastërtisë       | 192       | 54.2%     |
|       | Niveli i lartë i pastërtisë       | 86        | 24.3%     |
|       | Niveli shumë i lartë i pastërtisë | 9         | 2.5%      |
|       | Total                             | 354       | 100.0%    |

Tabela 6

### Niveli i pastërtisë në toalet/WC?

|              |                                   | Frekuenca | Përqindja |
|--------------|-----------------------------------|-----------|-----------|
| <b>VALID</b> | Niveli shumë i ulët i pastërtisë  | 77        | 21.8%     |
|              | Niveli i ulët i pastërtisë        | 144       | 40.7%     |
|              | Niveli mesatar i pastërtisë       | 98        | 27.7%     |
|              | Niveli i lartë i pastërtisë       | 29        | 8.2%      |
|              | Niveli shumë i lartë i pastërtisë | 6         | 1.7%      |
|              | Total                             | 354       | 100.0%    |

Tabela 7

### Niveli i rregullit gjatë procesit mësimor?

|              |                      | Frekuenca | Përqindja |
|--------------|----------------------|-----------|-----------|
| <b>VALID</b> | Niveli shumë i ulët  | 4         | 1.1%      |
|              | Niveli i ulët        | 21        | 5.9%      |
|              | Niveli mesatar       | 177       | 50.0%     |
|              | Niveli i lartë       | 143       | 40.4%     |
|              | Niveli shumë i lartë | 9         | 2.5%      |
|              | Total                | 354       | 100.0%    |

Tabela 8

### Në sa ndërresa punon shkolla?

|              |                | Frekuenca | Përqindja |
|--------------|----------------|-----------|-----------|
| <b>VALID</b> | Një ndërresë   | 18        | 5.1%      |
|              | Dy ndërresa    | 191       | 54.0%     |
|              | Tri ndërresa   | 130       | 36.7%     |
|              | Katër ndërresa | 15        | 4.2%      |
|              | Total          | 354       | 100.0%    |

Tabela 9

Sa zgjatë ora mësimore?

|       |           | Frekuenca | Përqindja |
|-------|-----------|-----------|-----------|
| VALID | 30 minuta | 7         | 2.0%      |
|       | 35 minuta | 32        | 9.0%      |
|       | 40 minuta | 278       | 78.5%     |
|       | 45 minuta | 37        | 10.5%     |
|       | Total     | 354       | 100.0%    |

Tabela 10

A u ofrohet studentëve/nxënësve përkrahje psiko-sociale dhe nga kush?

|       |  | Frekuenca | Përqindja |
|-------|--|-----------|-----------|
| VALID | Nuk ofrohet fare përkrahje psiko-sociale       | 83        | 23.4%     |
|       | Ofrohet nga psikologu i shkollës               | 140       | 39.5%     |
|       | Ofrohet nga mjeku i shkollës                   | 8         | 2.3%      |
|       | Ofrohet nga stafi i shkollës                   | 113       | 31.9%     |
|       | Ofrohet nga organizata të jashtme profesionale | 10        | 2.8%      |
|       | Total  | 354       | 100.0%    |

Tabela 11

A ndodh ndonjë diskriminim në baza rajonale në shkollë?

|       |            | Frekuenca | Përqindja |
|-------|------------|-----------|-----------|
| VALID | Asnjëherë  | 304       | 85.9%     |
|       | Rralëherë  | 21        | 5.9%      |
|       | Ndonjëherë | 24        | 6.8%      |
|       | Shpeshherë | 5         | 1.4%      |
|       | Total      | 354       | 100.0%    |

Tabela 12

A ndodh ndonjë diskriminim në baza gjinore në shkollë?

|              |            | Frekuenca | Përqindja |
|--------------|------------|-----------|-----------|
| <b>VALID</b> | Asnjëherë  | 289       | 81.6%     |
|              | Krahëherë  | 28        | 7.9%      |
|              | Ndonjëherë | 32        | 9.0%      |
|              | Shpeshherë | 5         | 1.4%      |
|              | Total      | 354       | 100.0%    |

Tabela 13

A ndodh ndonjë diskriminim në baza etnike në shkollë?

|              |            | Frekuenca | Përqindja |
|--------------|------------|-----------|-----------|
| <b>VALID</b> | Asnjëherë  | 325       | 91.8%     |
|              | Krahëherë  | 17        | 4.8%      |
|              | Ndonjëherë | 11        | 3.1%      |
|              | Shpeshherë | 1         | 0.3%      |
|              | Total      | 354       | 100.0%    |

Tabela 14

A organizohen veprimtari ekstra-kurrikulare me nxënësit në shkollë?

|              |             | Frekuenca | Përqindja |
|--------------|-------------|-----------|-----------|
| <b>VALID</b> | Asnjëherë   | 23        | 6.5%      |
|              | Krahëherë   | 71        | 20.1%     |
|              | Ndonjëherë  | 150       | 42.4%     |
|              | Shpeshherë  | 92        | 26.0%     |
|              | Vazhdimisht | 18        | 5.1%      |

Tabela 15

A mbahen mbledhjet zyrtare me prindër?

|              |  | Frekuenca | Përqindja |
|--------------|--|-----------|-----------|
| <b>VALID</b> | Mbahen vetëm mbledhjet zyrtare                                   | 23        | 6.5%      |
|              | Përveç atyre zyrtare, mbahen edhe mbledhje shtesë, sipas nevojës | 71        | 20.1%     |
|              | As ato zyrtare nuk mbahen rregullisht                            | 150       | 42.4%     |
|              | Nuk mbahen fare mbledhjet  | 92        | 25.0%     |
|              | Total  | 354       | 100.0%    |

Tabela 16

Si vlerësohet bashkëpunimi me prindër?

|              |              | Frekuenca | Përqindja |
|--------------|--------------|-----------|-----------|
| <b>VALID</b> | Shumë i keq  | 12        | 3.4%      |
|              | I keq        | 60        | 16.9%     |
|              | Mesatar      | 132       | 37.3%     |
|              | I mirë       | 122       | 34.5%     |
|              | Shumë i mirë | 28        | 7.9%      |
|              | Total        | 354       | 100.0%    |

Tabela 17

A vërehet mungesë e mësimdhënësve gjatë orarit zyrtar?

|              |            | Frekuenca | Përqindja |
|--------------|------------|-----------|-----------|
| <b>VALID</b> | Asnjëherë  | 12        | 3.4%      |
|              | Rrallëherë | 301       | 85.0%     |
|              | Ndonjëherë | 34        | 9.6%      |
|              | Shpeshherë | 7         | 2.0%      |
|              | Total      | 354       | 100.0%    |

Tabela 18

Sa është i kualifikuar kuadri?

|              |                    | Frekuenca | Përqindja |
|--------------|--------------------|-----------|-----------|
| <b>VALID</b> | 100 %              | 145       | 41.0%     |
|              | Rreth ose mbi 95 % | 153       | 43.2%     |
|              | Rreth ose mbi 90 % | 32        | 9.0%      |
|              | Rreth ose mbi 85 % | 8         | 2.3%      |
|              | Rreth ose mbi 80 % | 5         | 1.4%      |
|              | Rreth ose mbi 70 % | 8         | 2.3%      |
|              | Më pak se 70%      | 3         | 0.8%      |
|              | Total              | 354       | 100.0%    |

Tabela 19

A implementohen metodat bashkëkohore të mësimdhënies (puna në grupe, mësimi kabinetik, puna praktike, struktura E.R.R. etj.)?

|       |   | Frekuenca | Përqindja |
|-------|---|-----------|-----------|
| VALID | Po, nga të gjithë mësimdhënësit                     | 17        | 4.8%      |
|       | Po, nga një numër i madh i mësimdhënësve            | 165       | 46.6%     |
|       | Po, nga rreth gjysmë e mësimdhënësve                | 100       | 28.2%     |
|       | Po, por vetëm nga një numër i vogël i mësimdhënësve | 61        | 17.2%     |
|       | Jo, nga asnjë mësimdhënës                           | 11        | 3.1%      |
|       | Total   | 354       | 100.0%    |

Tabela 20

Çka e pengon më së shumti implementimin e metodave bashkëkohore të mësimdhënies?

|       |  | Frekuenca | Përqindja |
|-------|--|-----------|-----------|
| VALID | Mungesa e teksteve adekuate                          | 23        | 6.5%      |
|       | Numri i madh i nxënësve nëpër klasë                  | 68        | 19.2%     |
|       | Mungesa e mjeteve konkretizuese                      | 72        | 20.3%     |
|       | Mungesa e kabineteve/laboratorëve/punëtorëve/sallave | 177       | 50.0%     |
|       | Pasfshia apo joqalishmëria e mësimdhënësve           | 14        | 4.0%      |
|       | Total  | 354       | 100.0%    |

Tabela 21

A përdoren metodat bashkëkohore për vlerësimin e nxënësve (testet, esetë, përcjellja dhe vlerësimi i vazhdueshëm etj.)?

|       |   | Frekuenca | Përqindja |
|-------|---|-----------|-----------|
| VALID | Po, nga të gjithë mësimdhënësit                     | 38        | 10.7%     |
|       | Po, nga një numër i madh i mësimdhënësve            | 195       | 55.1%     |
|       | Po, nga rreth gjysmë e mësimdhënësve                | 91        | 25.7%     |
|       | Po, por vetëm nga një numër i vogël i mësimdhënësve | 30        | 8.5%      |
|       | Total   | 354       | 100.0%    |

Tabela 22

Për sa lëndë ka tekste mësimore?

|              |                               | Frekuenca | Përqindja |
|--------------|-------------------------------|-----------|-----------|
| <b>VALID</b> | Për të gjitha lëndët          | 254       | 71.8%     |
|              | Për ose mbi 90 % të lëndëve   | 37        | 10.5%     |
|              | Për ose mbi 80 % të lëndëve   | 2         | 0.6%      |
|              | Për ose mbi 70 % të lëndëve   | 3         | 0.8%      |
|              | Për ose mbi 60 % të lëndëve   | 4         | 1.1%      |
|              | Për ose mbi 50 % të lëndëve   | 3         | 0.8%      |
|              | Për më pak se 50 % të lëndëve | 51        | 14.4%     |
| Total        |                               | 354       | 100.0%    |

Tabela 23

Në rast se mungon teksti mësimor për lëndën, atëherë çfarë bën mësimdhënësi?

|              |   | Frekuenca | Përqindja |
|--------------|---|-----------|-----------|
| <b>VALID</b> | Ë përdor diktimin                                     | 98        | 27.7%     |
|              | Përgatit skriptë për nxënësit                         | 7         | 2.0%      |
|              | Ofron materiale të ndryshme të gatshme                | 9         | 2.5%      |
|              | I referon nxënësit për materialet që duhet të lexohen | 4         | 1.1%      |
|              | Nuk ofron fare literaturë                             | 2         | 0.6%      |
|              | Nuk mungojnë tekstet shkollore për asnjë lëndë        | 234       | 66.1%     |
|              | Total   | 354       | 100.0%    |

Tabela 24

A përdoret diktimi si metodë e ligjërimit nga mësimdhënësit?

|              |   | Frekuenca | Përqindja |
|--------------|---|-----------|-----------|
| <b>VALID</b> | Nuk përdoret fare                             | 226       | 63.8%     |
|              | Përdoret nga rreth 5 % e mësimdhënësve        | 46        | 13.0%     |
|              | Përdoret nga rreth 10 % e mësimdhënësve       | 11        | 3.1%      |
|              | Përdoret nga rreth 15 % e mësimdhënësve       | 5         | 1.4%      |
|              | Përdoret nga rreth 20 % e mësimdhënësve       | 9         | 2.5%      |
|              | Përdoret nga rreth 30 % e mësimdhënësve       | 11        | 3.1%      |
|              | Përdoret nga më shumë se 30 % e mësimdhënësve | 46        | 13.0%     |
|              | Total   | 354       | 100.0%    |

Tabela 25

Cili është problemi më i madh me tekstet shkollore?

|              |   | Frekuenca | Përqindja |
|--------------|---|-----------|-----------|
| <b>VALID</b> | Nuk janë adekuate për lëndën                                  | 33        | 9.3%      |
|              | Nuk janë adekuate për nivelin e nxënësve                      | 64        | 18.1%     |
|              | Nuk janë sa duhet profesionale (përmbajtësisht)               | 51        | 14.4%     |
|              | Nuk stimulojnë të menduarit kritik dhe interaksionin          | 112       | 31.6%     |
|              | Imponojnë vetëm aktivizimin e mësimdhënësit, e jo të nxënësve | 94        | 26.6%     |
|              | Total   | 354       | 100.0%    |

Tabela 26

Sa është e furnizuar shkolla me mjete didaktike?

|              |                               | Frekuenca | Përqindja |
|--------------|-------------------------------|-----------|-----------|
| <b>VALID</b> | Nuk është e furnizuar fare    | 8         | 2.3%      |
|              | Është e furnizuar dobët       | 47        | 13.3%     |
|              | Është e furnizuar mesatarisht | 139       | 39.3%     |
|              | Është e furnizuar mirë        | 158       | 44.6%     |
|              | Është e furnizuar shumë mirë  | 2         | 0.6%      |
|              | Total                         | 354       | 100.0%    |

Tabela 27

Sa është e furnizuar shkolla me mjete/rekuzita sportive ?

|              |                               | Frekuenca | Përqindja |
|--------------|-------------------------------|-----------|-----------|
| <b>VALID</b> | Nuk është e furnizuar fare    | 101       | 28.5%     |
|              | Është e furnizuar dobët       | 133       | 37.6%     |
|              | Është e furnizuar mesatarisht | 65        | 18.4%     |
|              | Është e furnizuar mirë        | 51        | 14.4%     |
|              | Është e furnizuar shumë mirë  | 4         | 1.1%      |
|              | Total                         | 354       | 100.0%    |

Tabela 28

Sa është e furnizuar shkolla me inventar të nevojshëm nëpër klasë?

|              |                               | Frekuenca | Përqindja |
|--------------|-------------------------------|-----------|-----------|
| <b>VALID</b> | Është e furnizuar dobët       | 48        | 13.6%     |
|              | Është e furnizuar mesatarisht | 81        | 22.9%     |
|              | Është e furnizuar mirë        | 212       | 59.9%     |
|              | Është e furnizuar shumë mirë  | 13        | 3.7%      |
|              | Total                         | 354       | 100.0%    |

Tabela 29

Sa është e furnizuar shkolla me mjete higjienike/teknike?

|       |                               | Frekuenca | Përqindja |
|-------|-------------------------------|-----------|-----------|
| VALID | Nuk është e furnizuar fare    | 27        | 7.6%      |
|       | Është e furnizuar dobët       | 39        | 11.0%     |
|       | Është e furnizuar mesatarisht | 60        | 16.9%     |
|       | Është e furnizuar mirë        | 208       | 58.8%     |
|       | Është e furnizuar shumë mirë  | 20        | 5.6%      |
|       | Total                         | 354       | 100.0%    |

Tabela 30

# Lista e shkurtesave

|       |  |
|-------|--|
| BIRN  | Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese           |
| MASHT | Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë |
| DKA   | Drejtoria Komunale e Arsimit                       |
| SHM   | Shkolla e mesme                                    |
| SHF   | Shkolla fillore                                    |



Projekti “Monitorimi i shërbimeve publike” përkrahët nga:



Rockefeller  
Brothers Fund  
Philanthropy for an Interdependent World



**B | T | D** The Balkan Trust  
for Democracy  
A PROJECT OF THE GERMAN MARSHALL FUND